



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "ENGINEERING RK shpk" të datës 21.07.2025 kundër njoftimit mbi vendimin lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Mbulimi i kulmit të rrafshët, renovimi i mureve të dëmtuara dhe riparimi i dyshemesë të shkollës "Qamil Batalli" me nr. të prokurimit 616-25-4319-5-2-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "ENGINEERING RK shpk" të datës 21.07.2025 kundër njoftimit mbi vendimin lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Mbulimi i kulmit të rrafshët, renovimi i mureve të dëmtuara dhe riparimi i dyshemesë të shkollës "Qamil Batalli" me nr. të prokurimit 616-25-4319-5-2-1.
- II. **AUTORIZOHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit të përcaktuar si në pikën I të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHEN** palët e interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik "ENGINEERING RK shpk" (tutje "parashtruesi") me datë 21.07.2025 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Mbulimi i kulmit të rrafshët, renovimi i mureve të dëmtuara dhe riparimi i dyshemesë të shkollës "Qamil Batalli" me nr. të prokurimit 616-25-4319-5-2-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtresit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtuar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtresit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet ankimore të parashtruesit:

Duke ditur faktin se oferta e jone eshte me e lira nga te gjitha ofertat e dorezuara per kete aktivitet te prokurimit ,nuk pajtohem me vleresimin e AK-komuna e Prishtines ,sepse konsiderojme qe kemi plotesuar kerkesat e AK dhe ka qene dashte te shperblehemi me kontrate.

Sa i perket argumenteve te AK -vleresimit po shkojme me radhe :

1/Konsiderojme qe valide per leshimin e qertifikateve jane institucionet arsimore dhe shkollat profesioanle se bashku me trupa qertifikuese ,te cilat jane adekuate per leshimin e qertifikatave ,referojuni te gjitha ligjeve aplikative ne Republikene kosoves dhe do te bindeni qe prodhuesit nuk guzojn em eleshu qertifikata per trajnime te punetoreve,por prodhuesi ne baze te ligjeve ne fuqi ka te drejte te leshojne qertifikata te konformitetin per te deshmuar kualitetin e prodhimeve te veta ,qdo leshim e qertifikatave te tjera per punetor ,apo edhe inxhinjer konsiderohet tejkalim i kompetencave ligjore edhe konsiderohet shkelje .

Inxhinjeri i jone z.Emin Rexhepi e ka qertifikaten nga institucioni perkates edhe eshte valide dhe e permbushe kerkesen e AK.

2/Tekniku i ndertimit eshte i qertifikuar nga shkolla e licencuar nga MASHT-i per natyren e ketyre qertifikimeve dhe ploteson kushtin e AK .qertifikatat ng aprodhuesit jane ne kundershtim te plote me ligjet aplikative ne Kosove

3.Sa i perket Damperit ne kemi dorezuar librezin kopje edhe eshte ne dosje te tenderit por si makine e punes me tabela 06-680 GP me karakteristika si n elibreze,dhe me nje kerkim te thjeshte ne internet e sheh se eshte damper ,kopjen e kerkimit dhe foton po ja bashkangjesim kerkeses per rishikim ,edhe ne kete pike jemi shume te pergjegjshem.

4/sa i perket mjeteve te punes i keni deshmit me fature tatimore dhe pagesen e bere ne banke per te njejten fature ,edhe ketu kemi plotesuar kete kusht dhe eshte e habitshme se te gjitha keto permes informatave shtese me eprokurim i kemi derguar tek AK -Komuna e Prishtines ,dhe prape ne vendim keni nxjerrur gjera te paverteta dhe te paqendrueshme.

Konsiderojme se te gjitha mangesit qe i keni permendur ne Vendim nuk qendrojne ,dhe oferta e jone eshte e pergjegjshme .

Sa i perket vendimit te Ak per shperblim me kontrate te GOE "ART-EDA SHPK & H& S PARTNER GROUP SHPK ,gjate egzaminimit te dosjes se tyre gjetem keto te gjetura : Ne baze te deklarate se konzorciumit ART -EDA SHPK ,ka per te kryer 98 % te punimeve ,nga dosja shihet se nuk posedon as nje kolice te vetme ,dhe te gjitha marreveshjet me inxhinjer i ka me parakontrata dhe me pajisje per huazim,dhe eshte e habitshme per ne si OE si mund te ndodhe kjo.

Se dyti qertifikatat e kerkuara i ka nga prodhuesit ne kundershtim me ligjet aplikative ne Kosove,dhe qertifikata e inxhinjerit eshte ne emer te kompanise Izolimi ,dhe ka qene dashte te posedoj marreveshje edhe me NP Izolimi.

Lidhur me pretendimet ankimore fillimisht duhet sqaruar se sipas letrës standarde për tenderuesin e eliminuar, parashtruesi është shpallur si tenderues i papërgjegjshëm dhe është eliminuar nga aktiviteti i prokurimit për arsyet si në vijim:

1. Inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë (pika 2.3): Kërkohej të jetë i certifikuar nga prodhues për sistemet hidroizoluese, kristalizuese, riparuese dhe mbrojtëse, me minimum 3 vite përvojë pas diplomimit. Grupi nuk ka ofruar dëshmi të certifikimit nga një prodhues të këtyre sistemeve, por vetëm një certifikatë nga një kompani që merret me shërbime të sistemit të menaxhimit, e cila nuk është kompani prodhuese. Bazuar në këtë OE nuk plotëson kërkesën e AK-së.
2. Teknik i ndërtimtarisë (pika 2.5): Kërkohej të jetë i kualifikuar nga shkolla e mesme profesionale, me minimum 3 vite përvojë pune pas diplomimit dhe të jetë i certifikuar nga një prodhues për përdorimin e materialeve të ndërtimit dhe riparimit. Grupi nuk ka ofruar dëshmi të certifikimit nga prodhuesi, por vetëm një certifikatë nga një kompani që merret me shërbime të sistemit të menaxhimit, jo nga një prodhues i materialeve. Bazuar në këtë OE nuk plotëson kërkesën e AK-së.
3. Mjet vetëshkarkues (damper) min. 2 m³ - së paku 1 copë (pika 3.3): Kërkohej kopje e librezës së qarkullimit valide si dëshmi. Grupi nuk ka ofruar kopje të librezës së qarkullimit, por vetëm faturën e blerjes. Në këtë mënyrë nuk plotëson kërkesën.
4. Mjet ngritës me kovë për vend punishte - së paku 1 copë (pika 3.4): Kërkohej kopje e faturës së blerjes së noterizuar së bashku me dëshmi pagese nga banka, kontratë shitblerje ose deklaratë doganore, 5. Hillt për demolim - së paku 2 copë (pika 3.5): Kërkohej kopje e faturës së blerjes së noterizuar së bashku me dëshmi pagese. 6. Përzierës për ngjitës - së paku 2 copë (pika 3.6): Kërkohej kopje e faturës së blerjes së noterizuar së bashku me dëshmi pagese. 7. Thithëse elektrike - së paku 2 copë (pika 3.7): Kërkohej kopje e faturës së blerjes së noterizuar së bashku me dëshmi pagese. 8. Rrafshuese gleti - së paku 2 copë (pika 3.8): Kërkohej kopje e faturës së blerjes së noterizuar së bashku me dëshmi pagese, OE për pajisjet e lartcekura nuk ka paraqitur dhe dëshmuar kërkesat sipas dëshmisë së kërkuara për pajisjet.

Lidhur me pretendimet ankimore të parashtruesit është gjetur se parashtruesi nuk ka përmbushur kërkesat e DT dhe ka dorëzuar ofertë të papërgjegjshme për arsyet e cekura si më sipër sipas konstatimeve të komisionit vlerësues të evidentuara dhe në letrën standarde për tenderuesin e eliminuar. Rrjedhimisht është gjetur se eliminimi i parashtruesit është bërë në mënyrë të drejtë. Ndërsa sa i përket pretendimeve ankimore lidhur me tenderuesin e rekomanduar është gjetur se përderisa vet parashtruesi ka dorëzuar ofertë të papërgjegjshme, i njëjti nuk mund të trajtohet fare si palë e interesuar në kuptim të nenit 4 par. 1 nënpar. 26 të LPP. Pavarësisht kësaj është gjetur se oferta e dorëzuar nga tenderuesi i rekomanduar është në përputhje me të gjitha kërkesat e DT si dhe specifikat teknike të DT.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi. Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. nënparagrafin b) lidhur me nenin 62 par. 62.1. nënparagrafin d) të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik. Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 23.07.2025


Visar SHEHU
 Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
 Komuna e Prishtinës

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.